



Lajmëtari informativ i Qytetit të Shkupit

SHKUPË

| Numër 29 | Viti VI | 26 qershor 2013 |

Numër
falas

BULEVARDI "ILINDEN" - 4 KORSI NGA QENDRA DERI NË KARPOSH 4



PASTAJ



PAMJE E RE EDHE PËR PJESËN E DYTË TË BULEVARDIT “BORIS TRAJKOVSKI”

Pjesa e dytë e bulevardit “Boris Trajkovski”, nga kryqëzimi me bulevardin Serbia deri në hyrjen e fabrikës së mëparshme „Staklarnica“, muajin e kaluar mori pamje të re. Pjesa me gjatësi 1 126 metra u bë me 4 korsi automobilistike, trotuare, ndriçim dhe gjelbërim të ri dhe zvogëloi kaosin në qarkullimin rrugor.

- Projekti për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit “Boris Trajkovski” është një nga projektet më të mëdha të Qytetit të Shkupit. Me zgjerimin e kësaj pjese, bulevardi u bë me 4 korsi automobilistike, me nga dy për çdo drejtim, me gjerësi 3,5 metra. Rruga automobilistike është asfaltuar me asfalt-betoni të

MË PARË



polimerizuar, në sipërfaqe prej rreth 16 000 metra katror. Përgjatë kësaj pjese Qyteti i Shkupit rregulloi kryqëzime me semaforë. Nga ana e djathtë e rrugës automobilistike është ndërtuar trotuar me pllaka begatoni, me gjerësi 2 metra, kurse nga ana majtë – trotuar me korsi për biçikleta, me gjerësi 4 metra. Është vendosur kanalizimi atmosferik me gjatësi 1 126 metra me profil të ndryshëm, nga Ø 500 deri në Ø 800 milimetra. Ura ekzistuese prej betoni të armuar mbi kanalin Usje u rinovua, gjë me të cilën u bë me 4 korsi automobilistike, me korsi për këmbësorë dhe korsi për biçikleta. Nga të dyja anët e pjesës së zgjeruar janë vendosur 64 shtylla për ndriçimin rrugor – tha kryetari Koce Trajanovski, në

hapjen për qarkullim të pjesës së dytë të bulevardit "Boris Trajkovski".

Trajanovski rikujtoi se Qyteti i Shkupit në tetor të vitit të kaluar hapi për qarkullim pjesën e parë të bulevardit të zgjeruar "Boris Trajkovski", e cila u ndërtua nga "Rampa" deri në kryqëzimin me rrugën "Heronjtë e popullit" me gjatësi 1 380 metra.

- Me zgjerimin, rruga ekzistuese e ngushtë u transformua në bulevard me 4 korsi automobilistike. U vendos edhe kanalizimi atmosferik me gjatësi 1 380 metra. Me përfundimin e plotë të projektit kapital për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Boris Trajkovski", kjo rrugë automobilistike me frekuencë të madhe, me gjatësi të përgjithshme 2,5 kilometra, mori një pamje të re duke zgjidhur problemin shumëvjeçar me të cilin ballafaqoheshin qytetarët e Shkupit. Në projektin për zgjerimin dhe rikonstruksionin e bulevardit "Boris Trajkovski", Qyteti i Shkupit investoi rreth 4 milion euro, para të siguruara nga Banka evropiane për rinovim dhe zhvillim, si kredi, dhe nga buxheti i Qytetit të Shkupit – theksoi kryetari Koce Trajanovski.



BULEVARDI "ILINDEN" - 4 KORSI NGA QENDRA DERI NË KARPOSH 4



Ekipe e Qytetit të Shkupit zgjeruan dhe rinovuan pjesën e tretë të bulevardit "Ilinden", në Karposh 3, gjë me të cilën projekti i ndërlukuar për depërtimin e këtij bulevardi të rëndësishëm përfundoi me sukses. Pjesën e tretë të bulevardit të zgjeruar "Ilinden" më 29 maj e dhanë edhe zyrtarisht në përdorim kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, Nikolla Gruevski dhe Kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva.

- Në këtë pjesë të tretë të zgjerimit, nga pompa e benzinës „Makpetrol“ deri në rrugën „Lubjanska“, në gjatësi 1 500 metra, bulevardi "Ilinden" u bë me katër korsi. Nga të dyja anët e bulevardit janë formuar trotuare të reja me gjerësi nga 2,5 metra, kurse bordurat janë zëvendësuar plotësisht. Ndërtimi i rrugës së re automobilistike u shfrytëzua për ndërtimin e kanalizimit të ri atmosferik me vend-derdhje dhe puseta të reja, me gjatësi 610 metra (Ø 200 dhe 300 milimetra). Për nevojat e rrugës automobilistike të zgjeruar është ndërtuar urë me beton të armuar me gjatësi 20 metra. Gjatë rikonstruksionit të bulevardit është vendosur edhe rrethimi mbrojtës prej teli i stadiumit KF „Lokomotiva“, me lartësi 8 metra, dhe gjatësi 157 metra. Për

ndërtimin e pjesës së tretë të bulevardit "Ilinden" Qyteti i Shkupit investoi rreth 65 milion denarë – tha kryetari Koce Trajanovski.

Trajanovski shtoi se në trasenë e bulevardit "Ilinden" është vendosur ndriçim rrugor plotësisht i ri, për të cilin janë investuar 9 milion denarë.

- Në pjesën e mesme të bulevardit është ndërtuar zhardinier me gjerësi të ndryshme nga 2,5 deri në 5 metra dhe gjatësi 2 000 metra. Nga ana e majtë dhe e djathtë e bulevardit është mbjellur



PASTAJ

Pjesa e parë e bulevardit të zgjeruar "Ilinden"

bar në sipërfaqe rreth 15 000 metra katror dhe është vendosur rrejt hidrant për ujitje. Në gjelbërimin e mesëm nga të dyja anët e bulevardit janë mbjellur 120 fidanë të llojit „mollë dekorative”. Për rregullimin e plotë të hortikulturës në pjesën e tretë të bulevardit “Ilinden” janë ndarë rreth 6,6 milion denarë. Me këtë, investimi i përgjithshëm për rikonstrukcionin dhe zgjerimin e pjesës së tretë të bulevardit “Ilinden” është rreth 80 milion denarë – theksoi kryetari Trajanovski.

Sa për të rikujtuar, në vitin 2010 Qyteti i Shkupit zgjeroi dhe rinovoi pjesën e parë të bulevardit “Ilinden”, nga kryqëzimi me bulevardin “Shën Klimenti i Ohrit” deri në kryqëzimin me bulevardin “8 Shtatori”, me gjatësi 2 140 metra. Për realizimin e këtij projekti kapital Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 3,3 milion euro. Në vitin 2011 u zgjerua pjesa e dytë e bulevardit “Ilinden”, nga kryqëzimi me bulevardin “8 Shtatori” deri te pompa e benzinës „Makpetrol” me gjatësi 280 metra, në të cilën Qyteti i Shkupit investoi rreth 20 milion denarë. Me zgjerimin e pjesës së tretë të bulevardit “Ilinden”, kjo rrugë automobilistike mori pamje të re në një sipërfaqe të përgjithshme prej rreth 4 kilometra.

MË PARË**PASTAJ**

Pjesa e dytë e bulevardit të zgjeruar "Ilinden"

MË PARË

PASTAJ



RRETHRROTULLIM LIDHI RRUGËT “BRIGADA E DYTË MAQEDONASE” DHE “LLAZO TRPOVSKI”

Rrugët “Brigada e dytë maqedonase” dhe “Llazo Trpovski”, në kufirin ndërmjet komunave Butel dhe Çair, muajin e kaluar u lidhën me rrethrotullim. Zgjidhja e re e qarkullimit rrugor kontribuoi për zvogëlimin e kaosit që më parë ishte pamje e shpeshtë në këtë kryqëzim, dhe me të rriti sigurinë për të gjithë pjesëmarrësit në qarkullimin rrugor.

- Rrethrotullimi ndërmjet rrugëve “Brigada e dytë maqedonase” dhe “Llazo

Trpovski” është formuar në nivelin ekzistues të rrugës automobilistike dhe ka një korsi automobilistike me gjerësi 5,5 metra, që shërben për të katër degët. Rruga automobilistike e re është shtruar me asfalt polimeri në 4 700 metra katror. Në degët e rrugëve “Brigada e dytë maqedonase” dhe “Llazo Trpovski” që të çojnë drejt rrethrotullimit janë ndërtuar trotuare të shtruara me pllaka begatoni, kurse në mesin e rrethrotullimit është mbjellur

gjelbërim në sipërfaqe 1 400 metra katror. Gjatë punëve ndërtimore të rrethrotullimit u ndërtua kanalizim i ri atmosferik, me profil 200 milimetra, me gjatësi 35 metra dhe me profil 300 milimetra me gjatësi 15 metra, që do të përcjellë ujërat atmosferik nga rruga automobilistike e re. Është ndërtuar edhe pusët kontrolluese me kapak dhe 4 vend-derdhje. U realizua edhe mbrojtja e rrjetit ekzistues të ujësjellësit, të tubave të kanalizimit dhe tubit të gazsjellësit Ø 219 milimetra. Qyteti i Shkupit në këtë projekt investoi 22 milion denarë – tha kryetari Koce Trajanovski, në hapjen zyrtare për qarkullim të rrethrotullimit të ri.

Trajanovski shtoi se në rrethrotullim është vendosur edhe ndriçim i ri rrugor, me 9 shtylla për ndriçim dhe 13 llamba.

- Për ndriçimin e kryqëzimit të ri të formuar Qyteti i Shkupit shpenzoi rreth 1,5 milion denarë, kurse për rregullimin e hortikulturës së ambientit përreth do të investojë 1,5 milion denarë – theksoi kryetari Trajanovski.

MË PARË



U RINOVUA RRJETI I UJËSJELLËSIT NË STAJKOVCI

Punët ndërtimore për rikonstruksionin e rrjetit ekzistues të ujësjellësit në vendbanimin Stajkovci u zhvilluan sipas dinamikës së parashikuar. Nga 28 degët e planifikuara me gjatësi të përgjithshme 5 116 metra, deri tani janë përfunduar gjashtë degë, me gjatësi të përgjithshme rreth 600 metra.

- Stajkovci është një nga vendbanimet më të mëdha në Komunën Gazi Baba, me rreth 500 amvisëri të cilat vite me radhë ballafaqohen me defekte të shpeshta të rrjetit vjetër dhe të amortizuar të ujësjellësit. Tani u krijuan kushte për rikonstruksionin e plotë të tij, kështu që tubat e vjetra do të zëvendësohen me tuba të reja polietileni me profil 100 milimetra, gjë me të cilën banorët do të kenë furnizim me ujë të pijshëm më me cilësi – theksoi



kryetari Koce Trajanovski, në fillim të rikonstruksionit të ujësjellësit.

Rikonstruksioni i rrjetit të ujësjellësit është rezultat i bashkëpunimit të mirë të Qytetit të Shkupit dhe komunës

Gazi Baba. Për realizimin e tij janë planifikuar rreth 18 milion denarë, nga të cilat 15 milion janë nga NP „Ujësjellës dhe kanalizim“, kurse 3 milion denarë janë nga buxheti i komunës Gazi Baba.

U PASTRUA KANALI KOZLE DHE NJË PJESË E SHTRATIT TË LUMIT VARDAR



Ekipet e Qytetit të Shkupit pastruan kanalin Kozle, duke mënjanuar 310 metra kub lym dheu, mbetje komunale dhe material ndërtimor. Vegjetacioni i ulët dhe i lartë në kanal dhe në afërsi të tij u krasit.

Nga poshtë urës „Todor Aleksandrov“ (ura e mëparshme „Binjaku“) në Aerodrom janë pastruar 960 metra kub lym dheu dhe materiale ndërtimore, kurse në anën e djathtë të shtratit të lumit Vardar është riparuar edhe penda e depërtuar në Lisiçen e poshtme.

Ekipet e Qytetit të Shkupit këto ditë po kryejnë pastrimin manual të vegjetacionit në pjerrësitë dhe shtratin e vogël të lumit Vardar, kurse kur do të bjerë niveli i lumit do të vazhdohet me pastrimin me makina të pjerrësive në lokacionet në komunën Gazi Baba dhe komunën Karposh.

PO NDËRTOHET INFRASTRUKTURA PËR NDËRTESAT E REJA NË AERODROM

Ndërtimi i infrastrukturës së re përgjatë rrugës “Brigada e tretë maqedonase” e cila do të jetë në funksion të ndërtesave të reja banesore që do të ndërtohen në afërsi është në vijim. Projekti përfshin ndërtimin e kanalizimit të ri atmosferik dhe të ujërave të zeza, ujësjellës dhe rrugë dhe trotuare të reja.

- Qyteti i Shkupit dhe komuna Aerodrom do të përfundojnë në kohë obligimet e tyre për ndërtimin e infrastrukturës së nevojshme që do të jetë në funksion të banorëve të këtyre objekteve

banesore që do të ndërtohen përgjatë rrugës “Brigada e tretë maqedonase”. Qyteti i Shkupit do të realizojë rrugën automobilistike kryesore në këtë pjesë, më saktë, rruga “Vasko Karangelevski” do të zgjerohet dhe do të bëhet me katër korsi automobilistike dhe trotuare të reja me gjatësi 1 458 metra, nga kryqëzimi me bulevardin “Jane Sandanski” deri në rrugën “Brigada e tretë maqedonase”. Në Qytetin e Shkupit në vijim është përgatitja e projektit për këtë rrugë automobilistike, dhe pres që ndërtimi i saj që të fillojë nga fundi i vitit. Zgjerimi i



kësaj rruge do të financohet nga buxheti i Qytetit të Shkupit. Këto ditë, në fazën përfundimtare është edhe ndërtimi i rrjetit të ujësjellësit për zonën e lartë dhe të ulët në Aerodromin e vjetër, kurse së shpejti do të zgjidhet edhe realizuesi i tubacionit të ujit të ngrohtë nëpër një pjesë të rrugës “Brigada e tretë maqedonase” – tha kryetari Koce Trajanovski, në fillimin e punëve ndërtimore të infrastrukturës së re.

Për ndërtimin e infrastrukturës së planifikuar, që është nën kompetencat e komunës Aerodrom, nga buxheti i komunës do të ndahen mjete me vlerë rreth 60 milion denarë.

NDALIM QARKULLIMI PËR AUTOMJETET NGARKUESE NË RRUGËT E QYTETIT



Më 1 qershor filloi regjimi sezonal i përkohshëm për lëvizjen e automjeteve të rënda ngarkuese në territorin e Qytetit të Shkupit. Ndalimi i lëvizjes së automjeteve të rënda ngarkuese vlen në intervalin nga ora 10 deri në orën 20 dhe do të zgjasë deri më 01.09.2013.

Një regjim i tillë vendoset për të mbrojtur rrugët automobilistike të qytetit nga mbingarkesa e madhe e automjeteve të rënda ngarkuese kur temperaturat e ajrit janë të larta. Ky regjim i qarkullimit rrugor nuk ka të bëjë me automjetet motorike të rënda që transportojnë mallra që prishen lehtë, preparate mjekësore dhe kafshë.

Qyteti i Shkupit apelon deri te transportuesit me automjete të rënda të respektojnë sinjalizimin e qarkullimit rrugor të vendosur.

Bilborde të unifikuara sipas tipit dhe formës filluan të vendosen muajin e kaluar në sipërfaqet publike në Shkup, gjë me të cilën u vendos rregull në reklamim. Panotë e reja reklamuese do të vendosen në 1100 lokacione nëpër qytet, dhe atë, do të vendosen 800 bilborde, 252 sity-light dhe panele 48 LCD.

- Në dy thirrjet publike që shpalli Qyteti i Shkupit për vendosjen e panove reklamuese në territorin e qytetit u zgjodhën 4 koncesionerë. Me kompanitë „Akcent media“, „Skrin-media“, „Kala pllakat“ dhe „Media – C“ janë nënshkruar kontrata për shfrytëzimin e lokacioneve



U ZGJIDH KAOSI ME REKLAMIMIN – U VENDOSËN BILBORDE TË REJA NË SHKUP

për vendosjen e panove reklamuese. Koncesionerët e zgjedhur kanë si obligim të vendosin pano reklamuese në territorin e qytetit të Shkupit sipas paketës së vetë të marrë, në të cilën precizohen lokacionet e sakta dhe tipi dhe forma e panosë reklamuese. Çdo koncesioner mori paketë me numër të njëjtë panosh reklamuese dhe atë, nga 200 lokacione për vendosjen e bilbordeve, nga 63 lokacione për sity-light dhe nga 12 lokacione për panele LCD. Unë u premtova qytetarëve të Shkupit se do t'i përkushtohem zgjidhjes së kaosit me reklamimin në sipërfaqet publike dhe ja tani ky premtim i imi u realizua. Ai ishte edhe qëllimi i thirrjeve publike të Qytetit të Shkupit, që për vendosjen e panove reklamuese në territorin e qytetit, të vendoset rregull në reklamim. Në këtë mënyrë Shkupi do të ketë bilborde, sity-light dhe panele LCD të unifikuara, dhe në të njëjtën kohë do të mënjanohej të gjitha panotë reklamuese që janë vendosur në mënyrë jolegale. Çdo bilbord i vendosur në mënyrë jolegale do të mënjanohej. Qyteti i Shkupit në thirrjet publike zgjodhi 4 kompani për të pasur konkurrencë në reklamim, më saktë që të mos ketë monopol gjatë marrjes me qira të hapësirës reklamuese – tha kryetari Trajanovski, në promovimin e bilbordeve të reja.

Trajanovski theksoi se forma dhe materiali nga i cili do të përgatiten panotë e reja reklamuese janë përcaktuar me Studimin për panotë reklamuese që për Qytetin e Shkupit e përgatiti konsultues i jashtëm i zgjedhur nëpërmjet thirrjes publike.

Çdo koncesioner i përgatit vetë panotë reklamuese, sipas tipit të dhënë të standardizuar për bilbord, sity-light dhe panel LCD.



U VENDOSËN STACIONET E REJA TË AUTOBUSËVE



Në stacionet e autobusëve në shumë lokacione nëpër Shkup muajin e kaluar u vendosën stacione të reja dhe të rregulluara. Gjithsej do të vendosen 226 stacione autobusësh nëpër qytet, kurse deri në fund të vitit do të montohen 50 stacionet e para.

- Me realizimin e këtij aktiviteti qytetarët do të kenë stacione autobusi të reja, moderne dhe të rregulluara, sipas kërkesave të tyre, dhe mendoj se do të plotësojnë plotësisht standardet e qarkullimit rrugor. Për blerjen e 226 stacioneve Qyteti i Shkupit nga Buxheti do të ndajë rreth 66 milion denarë, në tre vite fiskale – shpjegoi kryetari Koce Trajanovski.

Stacionet e reja janë klasifikuar në dy grupe: stacione Tip A – 178 (me dimensione 4,2 metra gjatësi dhe 1,4 metra gjerësi) dhe stacione dopjo Tip A – 48 (me dimensione 8,4 metra gjatësi dhe 1,4 metra gjerësi). Të gjitha tipat e stacioneve përbëhen nga: streha (shtylla mbajtëse dhe konstruktion me mbulesë); sipërfaqe xhami ndërmjet shtyllave me xham sigurimi të kalitur; tabelë informuese me emrin e stacionit, harta e qytetit, si dhe orari i autobusëve që kalojnë në stacionin e autobusit; stol për qëndrim dhe kosh për mbeturina.

Stacionet e autobusit janë përgatitur nga çelik i galvanizuar dhe që nuk ndryshket, të mbuluara me lekan, me xham të kalitur, kurse dizajni i tabelës informuese u zgjodh nëpërmjet konkursit publik.





„I PARI DERI NË MAJË“ PËR DYVJETORIN E TELEFERIKUT

Gara miqësore e alpinizmit në të cilën morën pjesë mbi 600 pjesëmarrës, garat e çiklizmit dhe zbavitja me yje

të njohura të muzikës ishin vetëm një pjesë e manifestimit „I pari deri në majë“ të organizuar me rastin e 1 qershorit -



dyvjetorit të ndërtimit të teleferikut në Vodno.

Garat deri te Kryqi i mileniumit kishin karakter garues. Në garën e alpinizmit deri në majën e Vodnos të parët arritën Rosica Kostova dhe Jovica Ristovski. Në garën e çiklizmit ROAD në majë arritën të parët Ivana Gerçakova dhe Nikolla Grbiq, kurse në garën e çiklizmit MOUNTAIN më të shpejtë ishin Tanja Peneva dhe Borçe Jordanovski. Në fund të garave të gjithë pjesëmarrësit në garë morën certifikatë për pjesëmarrje, kurse më të mirët u shpërblyen me kupa, prodhime dhe shpërblime në të holla. Emrat e garuesve që arritën kohët më të mira në konkurrencën për femra dhe meshkuj, u shkruan në tabelën e cila do të vendoset në majën e Vodnos dhe që do të plotësohet çdo vit.

Vizitorët që nuk morën pjesë në garë kishin mundësi të arrijnë deri në majën e Vodnos me teleferik dhe të zbavitën me programin e pasur muzikor, DJ set nga Radio Antena 5 dhe shfaqjen e yjeve të njohura muzikore. Në mbrëmje në Vodnon e mesme u organizua zbavitje me elitën DJ maqedonase.

Manifestimin „I pari deri në majë“ e organizoi Qyteti i Shkupit dhe NQP “Shkup”.





U FESTUA DITA E ZJARRFIKËSVE 2013



Qyteti i Shkupit më 20 maj tradicionalisht feston Ditën e zjarrfikësve, në stacionin e mbrojtjes kundër zjarrit në Autokomanda. Festimi filloi me nderimin solemn të zjarrfikësve të Shkupit, kurse komandanti i Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit të Qytetit të Shkupit, Bllagoja Menkovski, kryetarit të Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski i dorëzoi raport.

- Vitet e kaluara Qyteti i Shkupit punoi në modernizimin e pajisjeve të Brigadës për mbrojtjen kundër zjarrit. Për nevojat e Brigadës vitin e kaluar janë blerë dy pompa për ujë me kapacitet pompimi 1 500 litra në minutë, për të cilat u ndanë 1,3 milion denarë. Për zjarrfikësit u blenë këpucë profesionale mbrojtëse gjë për të cilën u ndanë rreth 700 000 denarë, dhe është përfunduar edhe furnizimi publik për skafandra mbrojtëse me led llamba për blerjen e të cilave janë shpenzuar 4,5 milion denarë dhe të cilat do të arrijnë në periudhën e ardhshme. Vitin e kaluar u punësuan 25 zjarrfikës të rinj, të cilët paraprakisht u trajnuan në shkollën e mesme „Marija Kyri Sklodovska“ dhe përvetësuan me sukses programin e parashikuar – tha kryetari Koce Trajanovski.

Kryetari Trajanovski, komandantit Menkovski i ndau çelësat e automjetit të ri komandues të markës „Dacia Duster“ për blerjen e të cilit u ndanë një milion denarë.

Përveç Trajanovskit, në festimin e Ditës së zjarrfikësve në stacionin Autokomanda morën pjesë edhe ministrja e punëve të brendshme, Gordana Jankulovska dhe drejtori i Drejtorisë për mbrojtje dhe shpëtim, Shaban Salju.

Në qendrën për dhurimin e gjakut në SHOH „Dare Xhambaz“

DHURUAN GJAK 177 GJAKDHURUES

Në Qendrën e re të hapur për dhurimin e gjakut në Shtëpinë e organizatave humanitare „Dare Xhambaz“, që nga hapja e saj më 18 prill deri sot kanë dhuruar gjak 177 gjakdhurues. Qendra punon nga e hëna deri të premten, nga ora 10 deri në orën 17, kurse të shtunën nga ora 09 deri në orën 14. Gjaku i dhuruar dërgohet në Institutin për transfuzion mjekësor.

Hapja e Qendrës për dhurimin e gjakut është rezultat i bashkëpunimit të shkëlqyer të Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit, Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, Institutit për transfuzion mjekësor dhe Qytetit të Shkupit.

- Qendra ditore për dhurimin e gjakut do të jetë nën patronazhin e Qytetit të Shkupit, i cili është Qyteti botëror i solidaritetit dhe humanizmit. Në këtë drejtim, Qyteti i Shkupit me ndarjen e mjeteve me vlerë rreth 200 000 denarë do të kontribuojë për promovimin e dhurimit të gjakut, humanizmit dhe solidaritetit në qytetin tonë. Këto mjete, Qyteti i Shkupit ia ndau Kryqit të kuq të qytetit të Shkupit për pajimin e qendrës ditore për dhurimin e gjakut. Në rregullimin e ambientit të



jashtëm në të cilin u shtruan pllaka dhe u vendosën stola, morëm pjesë NP „Rrugë dhe rrugica“ dhe NP „Parqe dhe gjelbërim“. Dhurimi vullnetar i gjakut paraqet shprehje të vlerave të larta etike, humanitare dhe morale. Të dhurohet gjak, të shpëtohet jeta e dikujt, udhëhequr nga ide altruiste është një vepër fisnikërie. Hapja e qendrës ditore për dhurimin e gjakut do t'u mundësojë qytetarëve në çdo kohë të kenë mundësi të dhurojnë gjak, duke rritur kështu rezervat

e këtij lëngu të çmuar dhe mundësitë për shpëtimin e jetëve – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në hapjen e Qendrës.

Në këtë Qendër do të jenë në dispozicion materiale informuese për dhurimin e gjakut të cilat përmbajnë informacione të dobishme për dhuruesit e gjakut. Edukimi i drejtë është faktor i rëndësishëm për motivimin e çdo dhuruesi gjaku të ardhshëm, si dhe motivacion plotësues për dhuruesit shumëfish të gjakut. Nëpërmjet kësaj qendre do të motivohen edhe të rinjtë në përfshirjen e tyre aktive si dhurues gjaku të rregullt, në përputhje me gjendjen e tyre të përgjithshme shëndetësore. Aktivitetet themelore të Qendrës për arritjen e qëllimeve më të larta janë: plotësimi i kapaciteteve të organizimit në pjesën e dhurimit të gjakut në territorin e qytetit të Shkupit, motivimi i dhuruesve potencial të gjakut dhe nxitja e atyre që kanë dhuruar gjak shumë herë, promovimi i shprehive të shëndetshme jetësore, si dhe shoqërimi, këmbimi i ideve dhe eksperiencave të dhuruesve të gjakut në Shkup.



TAKIMI NDËRMJET TË PARIT DHE MË TË MIRËVE

Në suazat e manifestimit tradicional „Takimi ndërmjet të parit dhe më të mirëve“, 27 maturantëve – nxënës të shkëlqyer të gjeneratës 2009/2013 nga 21 shkollat e mesme kryetari Koce Trajanovski u ndau mirënjohje dhe shpërblime në para.

- Manifestimi „Takimi ndërmjet të parit dhe më të mirëve“ ka si qëllim afirmimin e dijes dhe suksesit në shkollë të nxënësve të shkëlqyer të gjeneratës në shkollat e mesme të Qytetit të Shkupit dhe t'u jepet mirënjohje publike për rezultatet e arritura. Të nderuar nxënës të shkëlqyer të gjeneratës 2009/2013 në arsimin katërvjeçar dhe nxënës të shkëlqyer të gjeneratës 2009/2012 në arsimin trevjeçar – ju me sukseset dhe rezultatet tuaja arritët të afirmoni veten, shkollat tuaja por, edhe ne qytetarët e Qytetit të Shkupit dhe Republikën e Maqedonisë. Praktika ka treguar se çdo njeri i ri, i cili ka qenë nxënës



i shkëlqyer i gjeneratës ndërton të ardhme të suksesshme dhe arrin rezultate të larta në rrugën drejt zhvillimit profesional. Detyra më e rëndësishme e çdo institucioni arsimor është që të ju nxënës t'i zhvillojë dhe fuqizojë forcat fisnike krijuese dhe kreative. Kjo është rruga deri te dhurata dhe mirënjohja më e madhe që mund ta posedojë njeriu, e ajo është dija – i porositi kryetari Trajanovski nxënësit e shkëlqyer të gjeneratës.

U NDANË ÇMIMET PËR MATEMATIKANËT MË TË MIRË

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski u ndau diploma dhe vendime për shpërblime në të holla fituesve të garës së dytë në matematikë ndërmjet shkollave të mesme të Qytetit të Shkupit, që u mbajt më 11.05.2013 në ambientet e SHMQSH „Georgi Dimitrov“.

Në garën e matematikës morën pjesë 141 nxënës të vitit të I, II dhe III, nga 21 shkollat e mesme nën kompetencat e Qytetit të Shkupit, kurse këtë vit gara kishte edhe karakter ndërkombëtar me mysafirë nga Serbia dhe nga Bullgaria. Nxënësit konkurruan në dy grupe, nxënës të arsimit gjimnazial dhe nxënës të arsimit profesional.

Në garën ndërmjet nxënësve të vitit të parë – arsimit gjimnazial vendi i parë i takoi Gjorgjina Ceniq nga SHMQSH „Orce Nikollov“, ndërmjet pjesëmarrësve të vitit të dytë – arsimit gjimnazial më i miri ishte Bojan Lozanovski nga SHMQSH „Josip Broz Tito“, kurse nga pjesëmarrësit e vitit të tretë –

arsimi gjimnazial, vendi i parë i takoi Filip Zhakov nga SHMQSH „Georgi Dimitrov“.

Në garën ndërmjet nxënësve të vitit të parë – arsimit profesional vendi i parë i takoi Zdravko Todorov nga SHMQSH „Vlado Tasevski“, nga pjesëmarrësit e vitit të dytë – arsimit profesional e para ishte Emi Veselkoska nga SHMEJQSH „Vasil Antevski – Dren“, kurse nga pjesëmarrësit e vitit të tretë – arsimit profesional, më i miri ishte Antonio Mukoski nga SHMQSH „Vlado Tasevski“.



Parada e maturës 2013

SHESI „MAQEDONIA“ PULSOI NË RITMIN E KUADRILIT

Në sheshin „Maqedonia“ më 17 maj u mbajt „Matura 2013“ e shtata me radhë, kurse maturantët nga Shkupi iu bashkuan moshatarëve të tyre nga qindra qytete nga vendi dhe Evropa të cilët në të njëjtën kohë, pikërisht në mesditë, vallëzuan „kuadril“ nën tingujt e operës së Shtrausit „Lakuriqi i natës“.

Në „Parada e maturës“ të sivjetme morën pjesë 1 000 pjesëmarrës nga SHMQSH „Rade Jovčevski Korçagin“, SHMQSH „Nikolla Karev“, SHMQSH „Josip Broz Tito“, SHMQSH „Pançe Arsovski“, SHMQSH „Vëllezërit Miladinov“, SHMQSH „Gjorgji Dimitrov“, SHMMQSH „Dr. Pançe Karagjovov“, SHMEJQSH „Vasil Antevski Dren“, SHMEJQSH „Arseni Jovkov“, SHMQSH „Marija Kyri Sklodovska“, SHMNGJQSH „Zdravko Cvetkovski“, SHMQSH „Vlado Tasevski“, QSHAT „Boro Petrushevski“, SHMQSH „Dimitar Vlahov“,



SHMQSH „Orce Nikollov“, SHMQSH „Llazar Tanev“, QSHMBA „Ilija Nikolovski Luj“, SHSHKF „Metodi Mitevski Brico“ dhe Gjumnazi i 5-të privat. Parada e maturës u mbajt edhe në Kumanovë, Strumicë, Gjevgjeli, Ohër dhe Strugë.

Para fillimit të vallëzimit „kuadril“, maturantët bënë betimin

për mos përdorimin e dhunës dhe për tolerancë.

Sponsor të manifestimit „Parada e maturës 2013“ janë Qyteti i Shkupit dhe Agjencia për të rinj dhe sport, kurse përkrahës është edhe Delegacioni i Bashkimit evropian në Republikën e Maqedonisë.

SHKOLLAT E MESME U PARAQITËN PARA NXËNËSVE TË SHKOLLAVE FILLORE

„Së bashku për gjenerata të reja dhe më të lumtura“ është manifestimi në të cilin para nxënësve të shkollave fillore u paraqitën nxënësit e shkollave të mesme në territorin e komunës Gazi Baba, që u mbajt më 23 maj, në sheshin në Autokomanda. Në stendat e shkollave të mesme „Pançe Arsovski“, „Mihajlo Pupin“, „8 Shtatori“ dhe „Boro Petrushevski“, nxënësit e shkollave fillore kishin mundësi të informohen më me hollësi për profilet dhe drejtimet që mësohen në to, si dhe me mënyrat e regjistrimit në shkolla.

– Organizimi i kësaj zbavitjeje muzikore në të cilën marrin pjesë të gjitha shkollat e mesme në territorin e komunës Gazi Baba është një mundësi e shkëlqyer për paraqitjen e tyre para nxënësve të shkollave të mesme të ardhshme. Arsimi është fuqi, pikërisht vegla e cila më vonë do t’ju hapë të gjitha dyert dhe horizontet, prandaj



duhet të zgjidhni shkollën e mesme ku do të jepni maksimumin tuaj – i porositi të pranishmit kryetari Koce Trajanovski.

Në këtë eveniment me shfaqje muzikore-skenike u prezantuan nxënësit e shkollave të mesme në territorin e komunës Gazi Baba.



U KONSTITUUA KËSHILLI I QYTETIT TË SHKUPIT

Pas mbajtjes së zgjedhjeve lokale dhe vërtetimit të mandateve të marra, më 18 prill u mbajt seanca e parë konstitutive e Këshillit të Qytetit të Shkupit.

Këshilli i Qytetit të Shkupit zgjodhi kryetarin dhe anëtarët e Komisionit për verifikim, çështje mandatare, parashtrësia dhe ankesa të Këshillit të Qytetit të Shkupit, dhe si kryetare u zgjodh Slobodanka Aleksova. Pastaj, Komisioni verifikoi mandatet e këshilltarëve të Këshillit të Qytetit të Shkupit nga zgjedhjet lokale, ku koalicioni „Për Maqedoni më të mirë“ i udhëhequr nga VMRO-DPMNE fitoi 22 mandate këshilltarësh, koalicioni „Aleanca për të

ardhmen“ i udhëhequr nga LSDM fitoi 14 mandate, Bashkimi demokratik për integrim (BDI) fitoi 5 mandate, Partia demokratike shqiptare (PDSH) fitoi 3 mandate dhe Rinovimi demokratik për Maqedoninë (RDM) 1 mandat.

Anëtarë të Këshillit të Qytetit të Shkupit për 4 vitet e ardhshme janë:

Slobodanka Aleksova, Marija Andonovska, Josif Andreevski, Gjonul Bjraktar, Ali Berat, Aleksandar Biçikliski, Borçe Georgievski, Elizabeta Giovska, Marjan Dodovski, Elena Eftimova, Boris Zmejkovski, Slavçe Jovanovski, Pece Joveski, Vasilka Kitanoviq, Jovan Llazarev, Mihajlo Manevski, Irena Misheva, Vlado

Popovski, Esma Rexhepova-Teodosievska, Branislav Sarkanjac, Ljupço Trpeski, Verica Filipovska, Lindita Anastasova, Sonja Glinxharska, Lidija Gjorgjievska, Dragi Davçevski, Sanja Zinzirova, Dragi Kolčakovski, Konstantin Kratovaliev, Sofija Kunovska, Damjan Mançevski, Tihomir Matevski, Gjorgje Matevski, Predrag Trpeski, Dragan Vasilevski, Zoran Shapuriq, Alajdin Alija, Enver Kaçar, Liman Binasa, Bashkim Ameti, Qemal Musliu, Nusret Aziri, Idriz Orana, Halime Sajdiu dhe Denko Skalovski.

Në seancën konstitutive, si Kryetare e Këshillit të Qytetit të Shkupit u zgjodh Irena Misheva.

SEANCA E PARË E TRUPIT KOORDINUES TË KRYETARËVE TË KOMUNAVE



Pas zgjedhjeve lokale të vitit 2013, më 17 maj u mbajt seanca konstitutive e Trupit koordinues të kryetarëve të rinj të komunave të Shkupit. Kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, shfrytëzoi rastin për t'u uruar mandatin e marrë kolegëve të tij dhe u uroi punë të suksesshme katër vitet e ardhshme.

Trajanovski shprehu dëshirën që ky trup të vazhdojë me punën e suksesshme ashtu si edhe katër vitet e kaluara dhe se të gjithë kryetarët e komunave do të bashkëpunojnë për zgjidhjen e problemeve me të cilat ballafaqohen banorët e Shkupit.

QYTETI I SHKUPIT MORI CERTIFIKATËN ISO 9001:2008

Qyteti i Shkupit mori certifikatën për sistemin për menaxhimin me kualitet me standardin ISO 9001:2008, ngashtëpiandërkombëtare e certifikatave „Byro Veritas“ nga Parisi, filiali i Lubjanës. Sfera e veprimit e certifikatës së Sistemit për menaxhimin me kualitet është Zhvillimi dhe dhënia e shërbimeve në kompetencat e vetëqeverisjes lokale dhe Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetëqeverisjes lokale.

Sistemi për menaxhimin me kualitet do të kontribuojë për ngritjen e kualitetit të shërbimeve të qytetarëve dhe bashkësisë së bizneseve nga administrata e Qytetit të Shkupit, sipas procedurave të përcaktuara dhe standardizuara më parë.

Përgatitja e Sistemit për menaxhimin me kualitet zgjati 6 muaj dhe me përkushtimin e plotë të të punësuarve në Qytetin e Shkupit u përgatitën procedurat dhe proceset e punës të Sistemit. Kontrolli i parë i proceseve standardizuese u krye në periudhën nga data 25 deri më 27 shkurt të vitit 2013 nga filiali regjional i „Byro Veritas“ nga Lubjana, që rezultoi me dhënien e certifikatës ISO 9001:2008 Qytetit të Shkupit. Certifikata do të vlejë deri më 07.03.2016.



PËRFUNDOI LIGA E SHKOLLAVE TË MESME TË QYTETIT

Nën organizimin e Lidhjes së sportit të shkollave të mesme në Shkup, dhe nën patronazhin e Qytetit të Shkupit, edhe këtë vit u mbajtën ndeshjet e Ligës së shkollave të mesme për vitin shkollor 2012/2013 në basketboll, voleyboll, hendboll dhe futsal në konkurrencën për femra dhe meshkuj, dhe u organizuan me sukses edhe garat në bouling. Në pjesën e sporteve individuale u organizuan garat në atletikë, badminton, ping – pong, tenis, notim, shenjëtari dhe shah, kurse në suazat e Maratonës së Shkupit u mbajt kampionati ekipor i shkollave të mesme në disiplinën 5 000 metra.

Në suazat e Final four që u mbajt nga data 8 deri më 10.05.2013, 2 ekipet më të mira që fituan në konkurrencën për shkollat e mesme ishin:

- Në futsal meshkuj, më të mirët ishin SHSHKF „M.M – Brico“ dhe SHMQSH „Nikolla Karev“. Në futsal femra dy vendet e para i fituan SHSHKF „M.M – Brico“ dhe SHMQSH „Koço Racin“.

- Në hendboll meshkuj, triumfuan nxënësit e SHSHKF „M.M – Brico“ dhe SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“. Në hendboll femra më të mirat ishin nxënëset e SHSHKF „M.M – Brico“ dhe SHMQSH „Pançe Arsovski“.

- Në basketboll meshkuj triumfuan ekipet e SHSHKF „M.M – Brico“ dhe SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“, kurse në basketboll femra – ekipet e SHMQSH „Orce Nikollov“ dhe të SHSHKF „M.M – Brico“.

- Në voleyboll femra dy vendet e para i fituan nxënëset e



SHMQSH „Georgi Dimitrov“ dhe SHMQSH „Orce Nikollov“, kurse në voleyboll meshkuj - SHSHKF „M.M – Brico“ dhe SHMQSH „Vlado Tasevski“.

- Në bouling më të mirët ishin ekipet e SHSHKF „M.M – Brico“ dhe të SHMQSH „Dimitar Vlahov“.

Në sistemi e garave të shkollave të mesme në Shkup këtë vit shkollor morën pjesë 180 ekipe, kurse u mbajtën rreth 900 ndeshje garuese. Në garat e ligës së shkollave të mesme dhe turnetë morën pjesë rreth 5 000 nxënës-sportistë nga 28 shkolla të mesme në Shkup.

Dy ekipet më të mira në sportet kolektive në Final four të qytetit siguruan plasman në garat e shkollave të mesme ku u arritën rezultatet e mëposhtme:

Futboll femra:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |
| 2. SHMK „Ljupčo Santov“ | Kočani |
| 3. SHMK „Riste Ristevski-Riçko“ | Prilep |

Futboll meshkuj:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHMK „Dimitar Vlahov“ | Strumicë |
| 2. SHMK „Kiril Pejčinović“ | Tetovë |
| 3. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |

Futsal femra:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |
| 2. SHMK „Riste Ristevski - Riçko“ | Prilep |
| 3. SHMK „Ljupčo Santov“ | Kočani |

Futsal meshkuj:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHMK „Sami Frashëri“ | Kumanovë |
| 2. SHMK gjim. „Goce Delçev“ | Kumanovë |
| 3. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |

Hendboll meshkuj:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |
| 2. SHMK „Josip Broz-Tito“ | Manastir |
| 3. SHMQSH „Zdravko Cvetkovski“ | Shkup |

Hendboll femra:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |
| 2. SHMQSH „Pançe Arsovski“ | Shkup |
| 3. SHMK „Niko Nestor“ | Strugë |

Voleyboll femra:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHMK „Jane Sandanski“ | Strumicë |
| 2. SHMQSH „Georgi Dimitrov“ | Shkup |
| 3. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |

Voleyboll meshkuj:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHMK „Jane Sandanski“ | Strumicë |
| 2. SHMK „Koço Racin“ | Veles |
| 3. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |

Basketboll femra:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |
| 2. SHMQSH „Orce Nikollov“ | Shkup |
| 3. SHMK gjim. „Josip Broz-Tito“ | Manastir |

Basketboll meshkuj:

- | | |
|--|--------------|
| 1. SHSHKF „Metodi Mitevski-Brico“ | Shkup |
| 2. SHMK „Jane Sandanski“ | Strumicë |
| 3. SHMK „Dobri Daskalov“ | Kavadarci |

Në kampionatin shtetëror të shkollave të mesme në atletikë u arritën këto rezultate: vendi i parë në 100 metra femra – Valbona Selimi nga SHMQSH „Pançe Karagjozov; në 800 metra femra e para arriti Sermendie Latinovska nga SHSHKF „M.M – Brico“; vendi i parë në 400 metra femra i takoi Drita Islamit nga SHSHKF „M.M – Brico“; vendin e parë në stafetën 4x100 metra e fituan nxënësit e SHSHKF „M.M – Brico“. Më i miri në kërcim së gjati për meshkuj ishte Nikolla Zarkovski nga SHSHKF „M.M – Brico“, kurse vendi i parë në 1000 metra meshkuj i takoi Stefan Stojanovski nga SHMQSH „Koço Racin“. Në kampionatin e qytetit në vrapimin në 5 000 metra në suazat e Maratonës së Shkupit te meshkujt vendi i parë u takoi nxënësve të SHMQSH „Georgi Dimitrov“, kurse te femrat nxënësve të SHMQSH „Orce Nikollov“.



REKORDET, KARAKTERISTIKË E MARATONËS SË SHKUPIT 2013

Rekordet që u vendosën në korsi me gjatësi 42 195 kilometra, edhe në konkurrencën për meshkuj edhe në atë për femra, ishin karakteristikë kryesore e “MARATONA E SHKUPIT 2013” të sivjetme, që u mbajt më 11 maj nëpër rrugët e qytetit. Më i miri ndërmjet maratonasve ishte keniani Vajklif Bivot Kipkorir, i cili theu rekordin e korsi, kurse më e shpejta dhe me rekord te femrat ishte bashkëkombësja e tij Karolin Kipruto.

Në maratonën e Shkupit, tradicionalisht, u zhvilluan edhe 3 gara – gjysmë-maratona 21 097 metra, gara humanitare në 5 000 metra dhe gara për fëmijë Kolgejt-Mini maratona e Shkupit. Në garën e gjysmë-maratonës, në konkurrencën për meshkuj i pari arriti Kristijan Stoshij nga Serbia, ndërsa te femrat më e shpejtë ishte bashkëkombësja e tij Danijela Baraq. Në garën humanitare të 5 000 metrave më i shpejti në konkurrencën për meshkuj ishte Ilir Kelezi, kurse në konkurrencën për femra më e shpejta ishte Rosica Kostova. Kjo garë me gjatësi 5 kilometra zhvillohet për vrapues rekreativ dhe ka karakter masiv.

Në mini-maratonën Kolgejt në 500 metra (për shkollat fillore) më të mirët ishin Pavle Jovanovski dhe Anesa Hajdari.

Këtë vit, nëpër rrugët e Shkupit vrapuan mbi 3 600 pjesëmarrës nga 36 vende. Në suazat e maratonës së Shkupit, Federata e atletikës e Maqedonisë zhvilloi edhe Kampionatin shtetëror në maratonë.

Matja e kohës së pjesëmarrësve në gara u realizua me tag/çip dhe secili pjesëmarrës që përfundoi maratonën ose gjysmë-maratonën mori medalje. Në organizimin e maratonës u përfshinë edhe një numër i madh vullnetarësh, rreth 400 persona, si dhe të gjitha ndërmarrjet publike të Qytetit të Shkupit. Sponsor të “MARATONA E SHKUPIT 2013” janë Qyteti i Shkupit, Misioni evropian në Republikën e Maqedonisë dhe Agjencia për të rinj dhe sport.



MERRU ME SPORT FALAS NË PLAZHET E QYTETIT

Terrenet sportive të volejbollit në rërë të plazheve të qytetit „Park” dhe „Ura e gurit” dhe terrenet për hendboll në rërë në plazhin „Park” hapën dyert për pushuesit. Terrenet sportive për të gjithë nxënësit, qytetarët, klubet sportive ose shoqatat civile të interesuara do të jenë të hapura çdo ditë, nga ora 10 deri në orën 24. Caktimi i orarit mund të kryhet çdo ditë pune në telefonat



3297 – 238 dhe 3297 - 320 deri në orën 16:30, ose në vetë terrenin sportiv në të njëjtën periudhë.

Koha për shfrytëzimin falas është 1 orë.

Plazhi i qytetit „Ura e gurit” më 8 qershor u hap edhe zyrtarisht për vizitorët me koncertin e grupit kroat „Antenat”. Koncerti ishte vetëm fillimi i një vere të nxehtë në plazh. Gjatë katër muajve të ardhshëm janë planifikuar kino-mbrëmje dhe projeksione të filmave kult maqedonas dhe të huaj, festivali i filmit të shkurtër, ekspozita të artistëve të rinj dhe fotografike, turne sportive, zbavitje matine dhe karioke.

„NGISNI BIÇIKLETËN!” NË RRUGËT E QYTETIT

Nën moton „Ngisni biçikletën!” më 26 maj nëpër rrugët e Shkupit u organizua shëtitja promovuese me biçikleta. Manifestimi në të cilin morën pjesë një numër i madh qytetarësh ishte

nën organizimin e Qytetit të Shkupit dhe të Federatës së çiklizmit të Maqedonisë.

Qëllimi i kësaj shëtitje është popullarizimi i biçikletës si mjet transporti rekreativ dhe alternativ, përdorimi masiv i

të cilit ka një numër të madh përfitimesh pozitive.

- Qyteti i Shkupit i kushton vëmendje të madhe përmirësimit të kushteve për përdorimin e biçikletës në Shkup, nëpërmjet një numri të madh projektesh për përmirësimin e infrastrukturës. Angazhimi im është që shëtitje të tilla promovuese me biçikletë nëpër trase alternative të ketë të paktën një herë në muaj – tha kryetari Koce Trajanovski.

Trajanovski theksoi se shëtitja me biçikletë ka një numër të madh përfitimesh - biçikleta është mjet transporti ekologjik i cili nuk ndot, kontribuon për zvogëlimin e kaosit në qarkullimin rrugor, ka përfitime financiare etj.



LOJËRA SPORTIVE NDËRMJET NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME NGA SHKUPI DHE SOFJA

Me iniciativën e Lidhjes së sportit të shkollave të mesme në Shkup nga data 2 deri më 4 qershor në Sofje, Republika e Bullgarisë, u mbajt turneu në të cilin matën forcat ekipet e shkollave të mesme të Shkupit dhe Sofjes. Ekipet e dy qyteteve garuan në konkurrencën për meshkuj dhe femra në basketboll, hendboll dhe në volejboll në konkurrencën për femra. Ekipet e Qytetit të Shkupit përbëheshin nga nxënësit më të mirë në garat finale në shkallë të Qytetit të Shkupit në sportet adekuate.

Në garat sportive ekipet e Qytetit të Shkupit fituan në gjashtë gara në basketboll, hendboll dhe futboll të vogël në kategorinë për meshkuj dhe femra, kurse ekipet nga Sofja fituan në garën në volejboll në kategorinë për femra.

Medaljet për garuesit dhe mirënjohjet për profesorët e



kulturës fizike të cilët morën pjesë në organizimin e garave sportive i ndanë kryetarët e qytetit të Shkupit dhe Sofjes, Koce Trajanovski dhe Jordanka Asenova Fandakova, Kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva dhe Kryetari i Lidhjes së sporteve të shkollave të mesme të Shkupit, Vlatko Nedelkovski.

Kryetari Koce Trajanovski tha se qëllimi i këtyre garave është

thellimi i bashkëpunimit ndërmjet dy qyteteve dhe këmbimi i eksperiencave nga fusha e arsimit dhe sportit.

Gjatë kohës së qëndrimit në Sofje, kryetari Koce Trajanovski realizoi takim me kryetaren Fandakova dhe shumë drejtues të komunës së Sofjes, ku u bisedua për një numër të madh temash rreth gjendjes në të dy qytetet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen. Theksi u vu në temat nga fusha e qarkullimit rrugor, transportit dhe ekologjisë.



BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koce Trajanovski më 25 prill realizoi takim me ambasadorin e Republikës së Sllovenisë në Republikën e Maqedonisë, Branko Rakovec.

Në takim, ambasadori i Republikës së Sllovenisë i uroi kryetarin Trajanovski zgjedhjen e tij të dytë në këtë funksion të përgjegjshëm, dhe u shpreh dëshira për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në shumë nivele, duke pasur parasysh se Shkupi është qytet i vëllazëruar me Lubjanën dhe zhvillon lidhje miqësore me qytetin e Mariborit...



Me ambasadorin Branko Rakovec



Me ambasadorin Roman Vashchuk

... Më 25 prill kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski, u takua me Roman Vashchuk, ambasadori i Kanadasë, me Zhivko Gruevskin, konsull nderi i Kanadasë në Republikën e Maqedonisë dhe me Gjurgja Gj. Qeramillac, drejtoreshë e Seksionit për marrëdhënie ekonomike pranë ambasadës së Kanadasë në Beograd.

Ambasadori Vashchuk theksoi se është shumë i kënaqur nga bashkëpunimi në fushën e kulturës, arsimit, bashkëpunimit me sektorin e biznesit dhe në fushën e teknologjive informatike. Ai shprehu gatishmërinë për thellimin e lidhjeve të vendosura dhe inicioi bashkëpunim të ri në shumë fusha.

...Kryetarja e Këshillit të Qytetit të Shkupit, Irena Misheva, realizoi takim me delegacionin e qytetit të vëllazëruar Talin, Estoni. Delegacioni nga Talini, i udhëhequr nga kryetari i Këshillit të qytetit të Talinit, Tomas Vitsut, përbëhej nga njëmbëdhjetë anëtarë, të cilët në të njëjtën kohë janë edhe anëtarë të Këshillit këshillëdhënës për zhvillimin e qytetit të Talinit - „Vizons“. Anëtarët e këtij këshilli punojnë dhe japin ide produktive për zhvillimin e Talinit. Në suazat e aktiviteteve të tyre ata organizojnë vizita studimore në qytete, kurse këtë vit vizituan Shkupin.

Në takim u këmbyen eksperiencat për punën dhe rolin e Këshillave në dy qytetet, dhe u bisedua edhe për tema me interes



Takim me delegacionin nga Talini

të përbashkët, për decentralizimin, kulturën, arsimin, migracionin, si dhe për vizionet e ardhshme për zhvillimin e qyteteve.

... Në takimin që në ambientet e Qytetit të Shkupit u mbajt më 16 maj kryetari Koce Trajanovski dhe shefi i delegacionit të

Bashkimit evropian në Republikën e Maqedonisë, Aivo Orav, biseduan për bashkëpunimin e deritanishëm të shkëlqyer në shumë fusha nga të cilat, siç tha Trajanovski, më e rëndësishmja është kontrata që Qyteti i Shkupit e nënshkroi me Bankën evropiane për rinovim dhe zhvillim (EBOR) për kredi me vlerë 5,6 milion euro që do të shfrytëzohet për modernizimin e kontrollit të qarkullimit rrugor dhe për rikonstruksionin e bulevardit "Boris Trajkovski" (rruga e mëparshme "Prvomajska").

Kryetari Trajanovski dhe ambasadori evropian Orav u obliguan për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbajtjen e relacioneve të mira të ndërsjellëta...



Me euroambasadorin Aivo Orav

...Ambasadori i Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Republikën e Maqedonisë Pol D. Uolers në takimin e mbajtur më 26 prill uroi kryetarin Trajanovski për zgjedhjen e sërishme në këtë funksion, dhe u bisedua për thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve në disa nivele.

Qyteti i Shkupit është i vëllazëruar me dy qytete të SHBA-së, Tempit (1971) dhe Pitsburg (2001), dhe ka një bashkëpunim të frytshëm me ta...



Me ambasadorin Pol L. Uolers



Takim me përfaqësuesit nga Tempit, SHBA

...Kryetari Koce Trajanovski më 31 maj u takua me përfaqësues të qytetit të vëllazëruar të Tempit nga SHBA, Arizona. Bëhet fjalë për dr. Sara Meken, profesor Xhenis Frensin Vagner dhe profesor Glenis Nejsi Uestmorland, kurse qëllimi i vizitës së tyre në Shkup është realizimi i hulumtimit në suazat e studimit për lidhjet romantike të adoleshentëve. Ky hulumtim realizohet nëpërmjet anketave dhe intervistave në grup me adoleshentët në shkollat e mesme në Shkup.

Kryetari Trajanovski theksoi bashkëpunimin e mirë të deritanishëm me qytetin Tempit, këmbimin e rregullt të nxënësve dhe profesorëve dhe rezultatet pozitive nga ky aktivitet...

U festua 5 Qershori - Dita botërore e mbrojtjes së ambientit jetësor

NXËNËSIT DËRGUAN MESAZHE PËR AMBIENT JETËSOR MË TË SHËNDETSHËM



Hapësira para Guaskës në Parkun e qytetit ishte shumë e ngushtë për t'i mbledhur të gjithë nxënësit, ekologët dhe adhuruesit e natyrës të cilët u shoqëruan me këngë, shkruan mesazhe ekologjike, bënë vizatime me temë nga ekologjia, dërguan mesazhe për ambient jetësor të shëndetshëm dhe u përfshinë në mënyrë aktive në festimin e 5 Qershorit – Dita botërore e mbrojtjes së ambientit jetësor. Motoja e festimit të sivjetmë të 5 Qershorit ishte „Mendo – ha – mbro“, temë e dhënë nga Programi për mbrojtjen e ambientit jetësor i Kombeve të Bashkuara me qëllim që të dërgohet apel, që ushqimi të blihet



dhe konsumohet në mënyrë racionale dhe të zvogëlohet sasia e ushqimit të përdorur që përfundon si mbeturinë.

- Duhet të kuptojmë se pamjet shqetësuese të shkatërrimit të sotëm të ambientit jetësor nëpër botë janë realiteti ynë, të cilin duhet ta ndryshojmë sa më urgjentisht. Ngrohja globale, dëmtimi i shtresës së ozonit, zhdukja e shumë llojeve të bimëve dhe kafshëve, zhdukja e pyjeve, janë procese të vazhdueshme me pasoja të paparashikueshme. Prandaj, ndiqni dhe respektoni udhëzimet dhe rekomandimet për kursimin e ujit dhe energjisë, blini prodhime për të cilat nuk përdoret ambalazh plotësues, ndani mbeturinat, kujdesuni për oborrin tuaj dhe oborrin e shkollës suaj, ruani vendet e ekskursioneve... Apeloj deri te të gjithë qytetarët e Shkupit, të blejnë dhe konsumojnë ushqimin në mënyrë racionale, kurse atë që do të mbetet, të mos e hedhin në kontejnerë, por tepriçën e ushqimit ta ndajnë me ata që e kanë të nevojshëm, por që nuk kanë mundësi ta blejnë, ose ta dhurojnë në Qendrën për personat e pastrehë për të cilët kujdeset Qyteti i Shkupit dhe Kryqi i kuq i qytetit të Shkupit. Një pjesë e produkteve ushqimore mund të përfundojnë edhe në Kopshtin zoologjik ose në Stacionarin për kafshët endacake – i porositi kryetari Trajanovski nxënësit e pranishëm.

Ministri për mbrojtjen e ambientit jetësor dhe planifikimin hapësinor, Abdulakim Ademi, kryetari Koce Trajanovski dhe zëvendësit të përfaqësuesit të përhershëm të UNDP-së në Maqedoni, Alesandro Frakaseti, u dhuroi grafit nga nxënës të SHMSH „Llazar Liçenovski“ për bashkëpunim të mirë në kontinuitet.

Festimi i Ditës botërore për mbrojtjen e ambientit jetësor në Parkun e qytetit ishte nën organizimin e Qytetit të Shkupit dhe Ministrisë së ambientit jetësor dhe planifikimit hapësinor.



individual të rregulluar më mirë çmimi shkoi në duart e Marija Najdova, për oborr në komunën Kisela Voda; Për oborr të objektit për strehim kolektiv të rregulluar më mirë u nderua me çmim konvikti IPKQ „Zdravko Cvetkovski”; Për oborritin e firmës ose objektit afarist të rregulluar më mirë u nderua me çmim „ADING” SHA Shkup.

Për hartimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave fillore çmimi shkoi në duart e Filip Gravçevski, klasa 8b në SHF „Kole Nedelkovski”; Për

U NDANË ÇMIMET PËR KONTRIBUTIN MË TË MADH PËR AMBIENTIN JETËSOR



hartimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave të mesme çmimi i takoi Nadezhda Atanasova, klasa III 2, në SHMQSH „Orce Nikollov”; Për vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave fillore shkoi në duart e Sara Jaglikovska klasa III 2 nga SHF „Johan Hajnrih Pestaloci” dhe Aleksandra Gjorgjievska, klasa VII 1 nga SHF „Goce Delçev”, për vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave të mesme çmimi i takoi veprës së Martina Mijushkoviç, Bojana Kokinovska dhe Elena Miceva, nxënëse në vitin e dytë në SHMQSH „Nikolla Karev”.

Njësia punëtore Gjellbërimi i qytetit – rajoni Qendër i NP „Parqe dhe gjellbërime” mori mirënjohje për kontribut të veçantë në mbrojtjen e ambientit jetësor.

Kryetari i Qytetit të Shkupit Koco Trajanovski më 5 Qershor – Dita botërore e mbrojtjes së ambientit jetësor ndau çmimet për më të mirët në konkursin tradicional të Qytetit të Shkupit për zgjedhjen e kompanisë më ekologjike, kontributin më të madh në fushën e mbrojtjes së ambientit jetësor, për oborritin e shtëpisë, banesës institucionit, firmës ose objektit afarist të rregulluar më mirë, hartimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave fillore dhe shkollave të mesme dhe për vizatimin më të mirë me temë nga ekologjia për nxënësit e shkollave fillore dhe shkollave të mesme.

Si kompani më ekologjike (firma me zbatimin e suksesshëm të ISO 14001 dhe kontribut për ruajtjen e ambientit

jetësor) çmimi i takoi ADORA inzhiniering Shkup; për kontributin më të madh nga fusha e mbrojtjes së ambientit (persona juridik ose fizik të cilët në veprimtarinë e tyre kanë bërë më shumë për ruajtjen dhe përmirësimin e ambientit jetësor në Shkup) – çmimi i takoi SHMQSH „Nikolla Karev”; Për oborr të objektit për strehim



AKSION PËR PASTRIMIN E SIPËRFAQEVE PUBLIKE



Ekipet e Qytetit të Shkupit filluan aksionin për pastrimin e sipërfaqeve publike në komunat e Shkupit, dhe të parat në radhë ishin komunat Gazi Baba dhe Butel. Aksioni për pastrim në çdo komunë zgjat tre ditë, dhe përfshin pastrimin e deponive informale, krasitjen e degëve të drurëve, larjen e rrugëve, kositjen e barit

dhe intervenime në drejtim të përmirësimit të furnizimit me ujë të pijshëm.

Në terren punuan ekipet e NP „Higjiena komunale”, NP „Parqe dhe gjelbërim” dhe NP „Ujësjellës dhe kanalizim”.

- Për ndryshim nga viti 2009, kur ndërmarrjet publike kishin mekanizim të

vjetër dhe jofunksional dhe nuk ishin në nivelin e detyrës, sot gjendja është shumë më e mirë. Për nevojat e NP „Higjiena komunale” janë blerë 60 kamionë të rinj dhe automjete për ngritjen e mbetjeve, dy automjete speciale për pastrimin e rrugëve me fshesa, si dhe 60 000 kazanë plastik të cilët iu ndanë amvisërive individuale në qytet. Për nevojat e NP „Parqe dhe gjelbërim” janë blerë 40-të makina dhe automjete, kurse automjete dhe mekanizim janë blerë edhe për ndërmarrjet e tjera publike – tha kryetari Koce Trajanovski, në fillimin e aksionit.

Aksioni për pastrimin e sipërfaqeve publike në komunat e Shkupit u zhvillua në të njëjtën kohë me ciklin e nëntë të vizitave të kryetarit Trajanovski, në dhjetë komunat e Shkupit.

PËR TË 9 HERË NË VIZITË NË KOMUNAT E SHKUPIT



Me takimin me përfaqësues të bashkësive urbane dhe vendore të komunës Gazi Baba më 10 qershor filloi cikli i vizitave në të dhjetë komunat në qytetin e Shkupit. Në takimin në Gazi Baba morën pjesë kryetari i Qytetit të Shkupit, Koce Trajanovski dhe kryetari i Komunës Gazi Baba, Toni Trajkovski, drejtorët e ndërmarrjeve publike të qytetit, drejtues të sektorëve të administratës së Qytetit të Shkupit dhe të komunës Gazi Baba, si dhe përfaqësues të të gjitha bashkësive urbane dhe vendore.

- Në këto takime qytetarët nëpërmjet përfaqësuesve

të tyre të drejtpërdrejtë të bashkësive urbane dhe vendore kanë mundësi të bisedojnë me shërbimet e qytetit për problemet me të cilat ballafaqohen në jetën e tyre të përditshme, të ofrojnë propozime dhe ide për tejkalimin e tyre, si dhe të japin propozime për përmirësimin e punës së ndërmarrjeve publike. Takimet e deritanishme rezultuan me një numër të madh projektsh të cilat i propozuan

komunat dhe qytetarët, para së gjithash në fushën e qarkullimit rrugor, higjienës komunale dhe transportit publik. Këto takime janë jashtëzakonisht pozitive dhe paraqesin transparencë në mënyrën e punës së qeverisjes lokale, në drejtim të përmirësimit të jetës së qytetarëve të Shkupit – deklaroi Trajanovski.

Në takim përfaqësuesit e bashkësive urbane dhe vendore më shumë dhanë sugjerime rreth punës së NQP-së, dhe kërkuan që të rritet frekuenca e autobusëve dhe të vendosen linja të reja autobusi.

„SHKUPI PËRKUJTON” 50-VJETORIN E TËRMETIT TË SHKUPIT

Me rastin e shënimit të 50-vjetorit të tërmetit katastrofik në Shkup, Qyteti i Shkupit në koordinim me Sallën universale dhe institucione të tjera do të organizojë disa aktivitete mujore nën moton „Shkupi përkujton”, që ka si qëllim të përkujtojë ngjarjen tragjike. Me këtë projekt Shkupi në vitin 2013 përsëri duhet të bëhet „qendra” e botës, qytet që do të perceptohet si qytet modern, i hapur, kozmopolit, human dhe i sinqertë.

Në bashkëpunim me Ministrinë e punëve të jashtme, ambasadat maqedonase jashtë shtetit, shoqatat e maqedonasve në disa vende dhe qytete të vëllazëruara, do të shprehet mirënjohje deri te të gjithë vendet dhe qytetarët që ndihmuan pas tërmetit, kur 80 për qind e qytetit u shkatërrua ose u dëmtua, dhe në rrënojat e tij humbën jetën 1 000 njerëz, kurse 100 000 banorë mbetën pa shtëpi. Me platformën kreative „Shkupi ju falënderon”, Qyteti i Shkupit planifikon aktivitete me të cilat do të shprehë falënderimet për humanizmin e treguar në të kaluarën.

Të gjitha aktivitetet do të nxisin interesin për Shkupin si destinacion turistik frymëzues, do të dërgojnë mesazhin se qytetarët e Shkupit me gjenerata ndajnë të njëjtat vlera dhe se i



karakterizon guximi, humanizmi, vizioni dhe shpresa. Projekti ka si qëllim bashkimin e shkupjanëve, për t'i inspiruar të përfshihen në aktivitete dhe të nxisë ide të reja me të cilat të gjithë do të krenohemi.

Aktivitetet tashmë kanë filluar, kurse evenimente më intensive planifikohen në ditët para 26 Qershorit, me një eveniment qendror multimedial në atë ditë.

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE IZIIS



Kryetari Koce Trajanovski më 29 maj mori pjesë në konferencën ndërkombëtare të Institutit për inxhinieri tërmeti dhe inxhinieri sizmologjike (IZIIS), që u mbajt me rastin e 50 vjetorit të tërmetit katastrofik në Shkup.

- Më 26 qershor të vitit 1963 Shkupi përjetoi një katastrofë të madhe që mori 1070 jetë njerëzish dhe la pa shtëpi mbi 100 000 bashkëqytetarë. Kjo katastrofë për një moment ndaloi qytetin në rritjen e tij, por në të njëjtën kohë

tregoi se sot kur është e nevojshme njerëzimi di të bashkohet dhe të ndihmojë. Dua të falënderoj të gjitha vendet dhe qytetet që i ndihmuan atëherë Shkupit të rrënuar. Pikërisht me ndihmën shumë të madhe të bashkësisë ndërkombëtare, Shkupi arriti të ngrihet nga hiri dhe të transformohet në një kryeqytet modern të Republikës së Maqedonisë dhe të bëhet simbol i solidaritetit ndërkombëtar. Kjo ngjarje tragjike rriti edhe vetëdijen për nevojën e planifikimit dhe ndërtimit të objekteve të cilat mund t'u rezistojnë katastrofave të tilla natyrore. Standardet e vendosura për ndërtimet asizmike, si dhe numri i madh i objekteve në të cilat janë zbatuar këto standarde, janë treguesi më i mirë se sa seriozisht e ka kuptuar Qyteti i Shkupit nevojën për një qasje të tillë në ndërtimtari. Kontribut të madh për vendosjen e këtyre standardeve, para së gjithash ka Instituti për inxhinierinë e tërmeteve i cili kohët e fundit u bë edhe Instituti i UNEKSOS kategoria 2, i vetmi i tillë në fushën e inxhinierisë së tërmeteve, sizmologjisë dhe zvogëlimit të rreziqeve nga tërmetet e mëdha – theksoi para të pranishmëve kryetari Trajanovski.

FESTIVALI I TRETË I USHQIMIT ORGANIK



Në sheshin para „Skopje Sity Mall“ më 8 qershor u mbajt Festivali njëditor i ushqimit organik, që organizohet tradicionalisht për të tretin vit me radhë. Festivali ka për qëllim promovimin e bujqësisë organike si pjesë të rëndësishme, perspektive të prodhimit të qëndrueshëm. Gjatë kohës së festivalit vizitorët kanë mundësi të blejnë dhe të degustojnë prodhime nga pesëmbëdhjetë ekspozues maqedonas, prodhues të ushqimit organik.

KONKURS PËR ZGJEDHJEN E FOTOGRAFIKËS MË TË MIRË 2013

Qyteti i Shkupit shpalli konkursin për zgjedhjen e fotografisë më të mirë profesionale dhe amatore me motive nga Shkupi dhe fton profesionistët, amatorët dhe nxënësit, adhuruesit e fotografisë të konkurrojnë në përputhje me kriteret e përcaktuara. Kriteret përmbajnë pikat e mëposhtme:

- Motivet e fotografive të jenë nga Shkupi;
 - Të dorëzohen fotografi me motive të ndryshme nga Shkupi, sipas zgjedhjes së dorëzuesit;
 - Sipas dëshirës së dorëzuesit, mund të dorëzohen fotografi të kryera ditën ose natën;
 - Fotografitë e dorëzuara të jenë në format digjital jpg ose format tjetër, me rezolucion të lartë;
 - Fotografitë nuk duhet të jenë më të vjetra se 5 vjet;
 - Zgjedhjen e fotografive do ta kryejë komisioni special i formuar nga Qyteti i Shkupit;
 - Qyteti i Shkupit mban të drejtën t'i shfrytëzojë për nevojat e tij të brendshme të gjitha fotografitë që kanë arritur;
 - Qyteti i Shkupit do të organizojë ekspozitën për fotografitë e shpërblyera në një nga qendrat e veta kulturore;
- Në konkurs do të ndahen tre shpërblime për fotografinë

më të mirë – shpërblimi i parë është 50 000 denarë, i dyti 40 000 denarë dhe i treti 30 000 denarë.

Konkursi zgjat 60 ditë nga dita e shpalljes në mjetet për informim publik (25.05.2013). Çdo kandidat fotografitë e veta duhet t'i dorëzojë në CD, në zarf të mbyllur në këndin e sipërm të majtë të të cilit duhet të jetë shënimi „mos hap“, kurse në mes duhet të shënohet adresa e saktë e pranuesit. Zarfi nga ana e jashtme nuk duhet të ketë asnjë shenjë për dërguesin. Në zarfin e mbyllur duhet të ketë edhe dy zarfe të mbyllur dhe vulosur, nga të cilët njëri me shënimin „propozim“ nën shifër, kurse tjetri me dokumentacionin me të njëjtën shifër, në të cilin do të jetë dokumentacioni dhe identifikimi i dërguesit.

Adresa në të cilën duhet të dorëzohen propozim-fotografitë është: Qyteti i Shkupit, Sektori për zhvillim ekonomik lokal, bulevardi Ilinden numër 82, 1000 Shkup, me shënimin „Për konkursin për fotografinë më të mirë“, ose personalisht, në Arkivin e Qytetit të Shkupit.

Për informacione plotësuese të interesuarit mund të telefonojnë në numrin e telefonit 3297-218, çdo ditë pune nga ora 8:30 deri në orën 16:30.

DHJETË DITË BASKERFEST NËPËR RRUGËT E SHKUPIT

Mbi 100 artistë të rrugës nga njëzet vende e shndërruan Shkupin në teatër në skenë të hapur dhe zbavitën shkupjanët në „Baskerfest 2013“, të tetin me radhë, që filloi më 14 qershor. Dhjetë ditë vizitorët kishin mundësi të kënaqen me shfaqjet e zhonglerëve, kukullave, mjeshtërve të pantonimës, akrobatëve, si dhe me koncertet e shumta. Ndërmjet shfaqjeve më spektakulare mund të ndahen pikat e trupit

akrobatik italian „Il Posto“ dhe të grupit rok „Star boy“ nga Zelanda e Re, të cilët me shfaqjet e tyre kombinuan koreografinë akrobatike me elemente piroteknike.

Festivali ndërkombëtar i rrugës „Baskerfest“ është nën organizimin e Shoqatës civile „One way“, dhe nën patronazhin e Qytetit të Shkupit. Këtë vit „Baskerfest“ do të ketë turne edhe nëpër Maqedoni, që do të zgjasë deri më 3 korrik.



„SHKUP“

LAJMËTARI INFORMATIV I

QYTETIT TË SHKUPIT

Numri i parë i lajmëtarit informativ

„Shkupi“ u botua më:

10 dhjetor 2008

Kryeredaktor

Nedelčo Krstevski

Redaksia

Seksioni për marrëdhënie me
opinionin

Redaktor i fotografi së

Radomir Jovanović

Përkthyes dhe lektor

Vladimir Bogdanovski

OTON QYTETI I SHKUPIT

për botuesin

Kryetari i Qytetit

Koce Trajanovski

Bulevardi Ilinden 82

Telefon

02 3297 255

e-mail adresa

gragjani@skopje.gov.mk

Dizajni/Botol:

Graficki Centar Skopje

„ROJE TURISTIKE“ PËRSËRI NË QENDRËN E QYTETIT

Nga kjo verë, projekti „Rojë turistike“ përveç sheshit „Maqedonia“ do të realizohet edhe në sheshin „Kryengritja e Karposhit“. „Rojë turistike“ do të ketë në dy sheshet çdo ditë, nga ora 11 deri në orën 13. Projekti do të zgjasë deri në muajin nëntor, përkatësisht derisa të ketë kushte të volitshme atmosferike.

Projekti „Rojë turistike“ për herë të parë u realizua vitin e kaluar nën organizimin e Byrosë për turizëm dhe informacion të Qytetit të Shkupit në bashkëpunim me QKF „Karposh“. Ky projekt ka si qëllim promovimin e territorit të qendrës së qytetit para turistëve që vizitojnë qytetin tonë. Për një prezantim më mbresëlënës dhe më të besueshëm të monumenteve kulturore-historike, tetë pjesëmarrës të rinj në projekt përfunduan trajtimin në Byro dhe fituan dije adekuate për karakteristikat, historinë dhe rëndësinë e objekteve nga historia e pasur e Shkupit. Prezantuesit janë të veshur me veshje kombëtare maqedonase, karakteristike për periudha të caktuara kohore (veshje maqedonase antike, veshje e mesjetës, veshje e komitëve dhe veshje e pjesëmarrësve në LÇK-partizane).



GARË MASIVE ME PATINA NË BULEVARDIN ILINDEN



Mbi 500 fëmijë nga 18 shkolla fillore të Shkupit morën pjesë në garën me patina të dytën me radhë „Vrapojmë drejt së ardhmes“ që më 26 prill u zhvillua në bulevardin „Ilinden“.

Garën e organizoi Qendra kulturore për fëmijë „Karposh“ dhe Qyteti i Shkupit me qëllim nxitjen e shpirtit sportiv të rinjtë tanë dhe krijimin e shprehive për sport.

Vendin e parë në garën me patina e fitoi Gordan Nacev nga SHF „Bllazhe Konevski“ të cilit ju dhanë patina me pajisje mbrojtëse. Vendi i dytë i takoi Alek Magdevski nga SHF „Nevena Georgieva-Dunja“, edhe ai mori një komplet patinash. Vendi i tretë i takoi Valentino Karanfilovski,

gjithashtu nxënës i nxënës i SHF „Nevena Georgieva-Dunja“ i cili si shpërblim mori një komplet mbrojtës ose skafandër mbrojtës dhe mbrojtës për duart dhe gjunjët.

QKF „KARPOSH“ FESTOI JUBILEUN E 65-TË TË KRIJIMIT



Me një manifestim të pasur muzikor-skenik që u mbajt më 7 qershor në Sallën universale dhe me solemnitetin e rastit të organizuar në Muzeun e luftës maqedonase për sovranitet dhe pavarësi, që u mbajt më 6 qershor, Qendra kulturore për fëmijë „Karposh“ festoi 65 vjetorin e ekzistencës dhe punës së saj.

- Qendra kulturore për fëmijë „Karposh“ tashmë 65 vjet është një pjesë e pandarë e ambientit kulturor maqedonas, duke përfaqësuar shtëpinë e disa gjeneratave të talentuara fëmijësh. QKF „Karposh“ mund të mburret me faktin se fillimet e veta ia dedikojnë emra të jashtëzakonshëm të artit dhe sportit maqedonas. Hapat e parë të vegjël të karrierave të tyre të mëdha në këtë institucion i bënë dirigjentë të

njohur, solistë vokal, prima balerina, instrumentistë, kompozitorë dhe mjeshtër të mëdhenj shahu, gjë me të cilën këtë institucion të qytetit mund ta vëmë në radhën e institucioneve publike më të frytshme në shtetin tonë. QKF „Karposh“ edhe në të ardhmen do të jetë qendër e aktivizimit dhe edukimit fëmijëror, duke dhënë kontribut të rëndësishëm në jetën publike maqedonase – theksoi kryetari Koce Trajanovski, në hapjen zyrtare të manifestimit.

Solemniteti u mbajt nën moton „65 vjet Qendër kulturore për fëmijë „Karposh“-SINONIM I KRIJIMTARISË FËMIJËRORE DHE KULTURËS PËR FËMIJË. Sponsor i evenimentit ishte bashkëshortja e Presidentit të Republikës së Maqedonisë, Maja Ivanova, anëtare e mëparshme e

shtëpisë së pionierit, kurse në Sallën universale dhanë shfaqje Vjeçeslav Popovski – solist vokal; grupi i baletit të QKF „Karposh“ me pjesë nga „Liqeni i mjellmave“; performansa skenike-muzikore „Qyteti i borës“; „Ambasadorët e rinj“ – mysafirë Liljana



Terpiq dhe Jordan Samarxhiski; „Patinazh në skenë“; „Apriliada në skenë“; „Valle pa kufi“ - shfaqje e ansamblit folklorik; „Vallëzime moderne“ - grupi i vallëzimit; Viktorija Ivanovska në violinë; Darko Bageski kuartet-kitarë klasike; „Tanec“ dhe ansamblit folklorik i QKF „Karposh“.

Në suazat e manifestimit morën pjesë edhe personalitete publike të cilët kanë qenë pjesë e seksioneve të QKF „Karposh“: pianisti me famë botërore Simon Trpčevski, këngëtarja Viktorija Loba, ylli i muzikës pop dhe aktori Vlatko Ilievski dhe anëtarët e ansamblit folklorik „Tanec“.

Përveç seksioneve të shumta, QKF „Karposh“ organizon edhe manifestime të ndryshme në të cilat marrin pjesë fëmijët e kopshteve dhe shkollave fillore nga Shkupi dhe rrethinat. Manifestime të tilla janë: „Vallëzoh dhe këndoj për nënën time“, „Qyteti i borës“, „Vizatim në asfalt“, garë në kitarë klasike, Kitarë Fest - „Tremolo“, „Apriliada“, „Roleriada“, Festivali ndërkombëtar „Valle pa kufi“, „Kuisi shkollor“ „Sheshi i gëzuar në perëndim të diellit“ dhe shumë manifestime dhe evenimente të tjera.

Në suazat e festimit zyrtar të këtij jubileu të rëndësishëm, u promovua edhe Monografia 65 vjet QKF „Karposh“, film i projektuar dokumentar për QKF „Karposh“, u ndanë mirënjohje, dhe u këndua edhe himni i ri i QKF-së, autor i të cilit është Dragan Mijalkovski. Manifestimet për festimin e jubileut 65 vjet QKF „Karposh“ iu kushtuan karposhasve të mëparshëm, të tashëm dhe të ardhshëm...



СКОПЈЕ
СЕ 26.7.1963
СЕКАВА

Урбана Уметност

СКОПСКО ЛЕТО **2013**

skopje summer

ДИРЕКЦИЈА ЗА КУЛТУРА И УМЕТНОСТ - СКОПЈЕ DIRECTORATE OF CULTURE AND ARTS - SKOPJE